

FIGURA TË SHQUARA SHQIPTARE NË SHTYPIN FRANCEZ

BOTIMET TOENA

AURENC BEBJA

ALEKSANDËR MOISIU

NË SHTYPIN FRANCEZ TË KOHËS

1912-1935

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-327-35-2

ISBN 978-9928-327-36-9 (Kolana)

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

PËRMBAJTJA

Berlinezet e të gjitha moshave çmenden për të.....	12
Angazhimi i Aleksandër Moisiut në teatrin gjerman tëNju-Jorkut.....	14
Nën tingullin e kitarës.....	15
Moisiu	16
Dy oficerë gjermanë në arrati.....	17
Arrestimi i dy oficerëve gjermanë të arratisur	19
Lejtenant aviatori Moisiu, aktori gjerman	21
“Morgen post” - Aleksandër Moisiu, aviator në arrati.....	24
Si fishkëllejnë në Gjermani.....	26
Manifestime antisemite.....	28
Aleksandër Moisiu në turne në Holandë.....	30
Vajza e madhe e Tolstoit	31
Aleksandër Moisiu	33
Jashtë shtetit.....	38
Gjermani	39
Me aktorin tragjik gjerman Aleksandër Moisiun, i lindur në Trieste.....	41
Një vendim i papritur. Aktorët vjenezë nuk do të luajnë në “Atelier”.....	48
Pse Aleksandër Moisiu nuk do të vijë në Paris?	50

Çfarë po ndodh? Pse nuk vjen z. Aleksandër Moisiu të luajë në Paris?	52
Çështja e “Kammerspiele”-s. Arsyet e vërteta për mungesën e Aleksandër Moisiut	58
Çështja e “Kammerspiele”-s. Z. Gémier i përgjigjet z. Aleksandër Moisiu	61
Rreth festivalit. Një komunikim nga komiteti ekzekutiv i Unionit francez të teatrit	64
Ardhja e aktorit tragjik Moisiu	66
Letër nga Austria. Tek Aleksandër Moisiu para ardhjes në Paris.....	68
“Franca ka stil”, “Gjermania është laborator”, na tha z. Aleksandër Moisiu.....	71
Një gjykim i jashtëm. Teatri në Francë, deklaroi Moisiu, është shumë më superior se ai i paraluftës	76
Aleksandër Moisiu	79
Në “Atelier” Z. Aleksandër Moisiu te “Kufoma e gjallë”	82
Në “Atelier” Aleksandër Moisiu.....	88
Aleksandër Moisiu në “Atelier”.....	90
Një aktor i madh gjerman në Paris. Z. Moisiu në pjesën “Hamleti”, në teatrin “Atelier”	93
Moisiu dhe publiku parisien.....	97
Aleksandër Moisiu falënderon Parisin.....	100
Teatri “Atelier” - Hamleti i Shekspirit, me Aleksandër Moisiun	102
Paris -Vjenë - Paris. Z. H.-R. Lenormand na flet për krijimin e “Frikacakut”	104
Aleksandër Moisiu, i sapokthyer nga SHBA: “I gjithë arti i filmit pa zë do të shuhet pas vdekjes së Çarli Çaplinit”.....	107

Ngacmim grotesk, por hitlerian	109
Argjentinë.....	111
Moisiu do të luajë një film me zë.....	112
Aleksandër Moisiu do të luajë rolin e Napoleonit	114
Rumani: Si luajti Aleksandër Moisiu përballë karrigeve bosh..	115
Artet: Një konkurs pantomimash.....	117
Aktori i famshëm	119
A do të dalë në pension Aleksandër Moisiu?	121
Turnetë e Aleksandër Moisiut “Idioti”	123
Turneu i Moisiut “Idioti”	125
Nderim për interes.....	129
Një aktor i kujdesshëm.....	131
Aleksandër Moisiu i përndjekur.....	133
Teatër: “I burgosuri” i Aleksandër Moisiut do të luhet në Paris	135
Njëqindvjetori i Goethe-s në Teatrin komunal.....	137
Mbrëmja “Goethe”	138
Mbrëmja e madhe “Goethe”	140
Jeta teatrale: Mbrëmja “Goethe” në Teatrin komunal.....	143
Jeta teatrale: Mbrëmja “Goethe” në Teatrin komunal.....	147
Moisiu në Bruksel	149
Itali	150
Vdekja e aktorit gjerman: Aleksandër Moisiu	152
Austri: Vdekja e Aleksandër Moisiut.....	153
Aleksandër Moisiu	154
Fundi i një tradite të habitshme shekullore “Unaza Iffland” u zhduk përgjithmonë	157
Trupi i Moisiut u varros në Ticino	160

Hyrje

Aleksandër Moisiu ka lindur më 2 prill 1879 në Trieste dhe është ndarë nga jeta më 23 mars 1935 në Vjenë.

Marrëdhëniet e këtij gjiganti të skenës me Francën kanë qenë vërtetë speciale, të llojit “*je t’aime, moi non plus...*”. Si një ikonë e teatrit të Kontinentit të Vjetër, shtypi francez i kohës i ka kushtuar një seri shkrimesh që nga viti 1912 e deri më 1935-n, duke ndjekur në këtë mënyrë lëvizjet e tij nëpër disa shtete si në Francë, Austri, Gjermani, Itali, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Holandë, Argjentinë, Rumani dhe Belgjikë.

Kritika franceze e mirëpret artin e tij në vitet 1912 – 1913, por gjatë Luftës së Parë Botërore, ai do të angazhohet apo do të detyrohet të angazhohet në ushtrinë gjermane, në skuadriljen e aviatorëve. Marrëdhëniet e tij me francezët logjikisht do të ftohen. Në shtator të 1915-s i kapet rob në Champagne (Francë). Në mars të 1916-s tenton të arratiset gjatë një transferimi në burgun e Toulouse-s (Francë). Hidhet nga treni bashkë me një tjetër gjerman duke u fshehur kështu në një pyll. Shumë shpejt do të kapet dhe do të dorëzohet para autoriteteve franceze. Detajet e kësaj arratie dhe kapja janë përshkruar në mënyrë të hollësishme nga shtypi lokal i kohës. Në qershor të 1916-s, e transferojnë në Gjenevë

(Zvicër) bashkë me 25 të burgosur gjermanë (bëhet fjalë për një shkëmbim të burgosurish franko-gjermanë).


Rikthimi i tij i fuqishëm në skenën e teatrit francez dhe “pajtimi” me publikun vendas do të ndodhë vetëm disa vite më vonë, në tetor të 1927-s, megjithëse ishte parashikuar që të shkonte në qershor të po atij viti, por disa mosmarrëveshje ose keqkuptime bënë që ky rithkim të shtyhej për disa muaj. Aleksandër Moisiu do të shkëlqejë në Francë duke aktruar si në gjuhën e Gëtes ashtu edhe në atë të Molerit.

Me këtë rikthim të suksesshëm në Francë, gazetatat vendase do të vazhdojnë të ndjekin nga afër aktivitetin e talentit me origjinë shqiptare duke e mbajtur kështu gjithmonë e më pranë publikut francez, deri në frymën e tij të fundit.

Aurenc Bebja

**ALEKSANDËR MOISIU DO TË LUAJË PRANVERËN
E ARDHSHME NË TEATRIN “ARGJENTINA”,
NË ROMË**

Comoedia, e shtunë, 15 qershor 1912, faqe 5:



Aleksandër Moisiu, i cili momentalisht luan në Paris në “Sumurun” dhe që do të paraqesë prologun, së shpejti do të shkojë në Firence te poeti Luis Naci, i cili shkroi për të një përkthim në italisht të “Hamletit” dhe “Edipit”.

Moisiu do t’i studiojë këto role në Itali dhe do t’i interpretojë ato në Romë pranverën e ardhshme në teatrin “Argjentina”.

BERLINEZET E TË GJITHA MOSHAVE
ÇMENDEN PËR TË

Comoedia, e enjte, 17 tetor 1912, ballinë:


Échos

Voilà, en tête des Informations, les spectacles nouveaux de la journée.



A h! les dames!
 Les Parisiens connaissent M. Alexandre Moissi. C'est lui qui, dans sa pantomime orientale que nous a présentée M. Reinhardt, jouait le poétique marchand de tapis dont toutes les femmes du harem sont éprises.

Or, il paraît que dans la vie courante M. Moissi n'a pas moins de bonheur que dans *Sumurun*. Les Berlinoises de tous âges sont folles de lui.

Ah! Zonjat!

Parisienët e njohin Aleksandër Moisiun. Është ai që, në pantomimën e tij orientale, të prezantuar nga z. Reinhardt, luante tregtarin poetik të qilimave, me të cilin të gjitha gratë e haremit bien në dashuri.

Por, duket se edhe në jetën e përditshme z. Moisiu nuk është më pak i lumtur sesa në “Sumurun”. Berlinezet e të gjitha moshave çmenden për të.

Javën e kaluar, artisti i ri mbajti në një sallë të veçantë një seancë recitimi; kishte shumë njerëz dhe britma entuziazmi. Në momentin kur u përul për të falënderuar publikun, një grup grash u ngjit në skenë dhe nxitoi drejt aktorit; secila t’i prekte më parë dorën, krahun apo faqet; ato që nuk mundën ta përqaфонin, kënaqeshin vetëm duke e prekur; ato që nuk mundën të afroheshin, shtypnin brinjët e atyre që i bezdisnin. Situata u bë aq serioze saqë z. Moisiu, të cilit po i merrej fryma, u detyrua të kërkonte ndihmë. U desh ndërhyrja e policisë për të shpëtuar z. Moisiu, i cili mund të ndihet i lodhur për një kohë të gjatë nga zonjat.

**ANGAZHIMI I ALEKSANDËR MOISIUT
ME TEATRIN GJERMAN TË NJU-JORKUT**


Comoedia, e enjte, 6 nëntor 1913, faqe 5:



Aleksandër Moisiu, aktori i Kompanisë së Reinhardt-it, të cilin parisienët e duartrokitën në “Sumurun”, sapo ka nënshkruar një kontratë me teatrin gjerman të Nju-Jorkut, ku merr përsipër të japë 10 shfaqje çdo vit gjatë periudhës së Krishtlindjeve.

NËN TINGULLIN E KITARËS

L'Oeuvre, e premte, 17 shtator 1915, faqe 4:




“La Tribuna” thotë se Princi i Kurorës, shtabi i përgjithshëm i të cilit gjendet në territorin francez, kërkon të dëfrehet midis betejave që ndërmerr dhe se ia del mbanë.

Ai ndien kënaqësi të veçantë kur dëgjon aktorin triestin Aleksandër Moisi, i cili pasi u natyralizua prusian, iu bashkua ushtrisë gjermane si vullnetar. Ai argëton Princin e Kurorës me recitime ose me kitarën e tij.

MOISIU

La France, e martë, 1 shkurt 1916, faqe 3:



Aktori gjerman Aleksandër Moisiu, i cili erdhi për të ekspozuar në Paris, nëpërmjet kompanisë së Max Reinhardt-it, shtatin e tij atletik në rolin e zezakut te pjesa "Sumurun", u burgos nga trupat tona në Champagne, gjatë shtatorit të kaluar.

Meqënëse është i sëmurë dhe me ndërhyrjen e Kryqit të Kuq, ai do të internohet në Zvicër.

DEUX OFFICERË GJERMANË NË ARRATI

La Dépêche, e diel, 5 mars 1916, faqe 5:

Deux Officiers boches s'évadent

L'autre nuit, deux officiers boches faisant partie d'un lot de prisonniers transférés à Toulouse ont sauté du train en marche du côté de la station de Montbartier, et, échappant aux recherches immédiatement organisées, se sont réfugiés dans la forêt de Montech où ils se cachent sans doute encore. Des battues vont être effectuées.

Mais voici, pour aider nos paysans aux recherches, le signalement de ces Boches :

Alexander Moissi, 32 ans, sous-lieutenant de réserve appartenant à la 18e escadrille d'aviateurs; taille 1 m. 71, cheveux châains, yeux bruns, front droit; gros nez, grande bouche, visage ovale.

Hans Werner, 28 ans, sous-lieutenant de réserve aussi; taille 1 m. 84, cheveux châains, yeux bleus; visage allongé, menton saillant; porte des cicatrices au front, à la joue gauche et à la lèvre supérieure.

Natën që kaloi, dy oficerë gjermanë që i përkisnin një grupi të burgosurish të transferuar në Toulouse u hodhën nga treni në ecje e sipër në afërsi të stacionit të Montbartier-it dhe, duke u shpëtuar kërkimeve të organizuara menjëherë, u strehuan në pyllin e Montech-ut, ku ndoshta gjenden ende të fshehur. Do të fillojnë menjëherë kërkimet.

Për të ndihmuar fshatarët tanë që t'i kërkojnë, po japim përshkrimin e këtyre gjermanëve sa më poshtë:

Alexandre Moïssi 32 vjeç, nën-toger (lejtentant) rezerve i skuadriljes të 18-të të aviatorëve; gjatësia 1 m. 71, flokë ngjyrë gështenjë, sy kaf, ballë të sheshtë, hundë të madhe, gojë të madhe, fytyrë ovale.

Hans Werner, 28 vjeç, gjithashtu një nën-toger (lejtentant) rezerve; gjatësia 1 m. 84, flokë ngjyrë gështenjë, sy blu; fytyrë e zgjatur; ka cikatrice në ballë, në faqen e majtë dhe në buzën e sipërme.

**ARRESTIMI I DY OFICERËVE GJERMANË
TË ARRATISUR**

La Dépêche, e martë, 7 mars 1916, faqe 2:

Arrestation des officiers boches évadés

Ayguesvives (Haute-Garonne), 6 mars. — Les deux officiers boches, Alexander Moissi et Hans Werner, dont nous avons annoncé l'évasion le 5 mars, dans le train de Montauban à Toulouse, tout près de la station de Montbartier, et qui s'étaient réfugiés dans la forêt de Montech, ont été arrêtés hier sur le territoire de la commune d'Ayguesvives (Haute-Garonne).

C'est M. Osmin Ducros, éclusier à Ticaille qui, les ayant reconnus, les a, avec l'aide de MM. Armand Dubourg, patron de la barque « Jeune-Firmin », en résidence à Castets-en-Dorthe (Gironde); Germain Laussac, postillon à la dite barque; François Marquié, soldat au 17^e escadron du train des équipages à Montauban, en permission de vingt-quatre heures; Jean Cazaux, concierge de la maison Pilter, de Toulouse, de passage à Ayguesvives, enfermés dans un petit local et les a signalés à la gendarmerie de Montgiscard, qui les a définitivement arrêtés.

Ayguesvives (Haute-Garonne), 6 Mars - Të dy oficerët gjermanë, Alexander Moissi dhe Hans Werner, arratisjen e të cilëve e njoftuam më 5 Mars, në trenin nga Montauban në Toulouse, shumë afër stacionit Montbartier dhe të cilët u strehuan në pyllin Montech, u arrestuan dje në territorin e komunës së Ayguesvives (Haute-Garonne).

Ishte z. Osmin Ducros, rojë digash në Ticaille, i cili pasi i njohu, i mbylli me ndihmën e zotërinjve Armand Dubourg [pronar i anijes “Jeune-Firmin”, me vendbanim në Castets-en-Dorthe (Gironde)], Germain Laussac [pilot në të njëjtën anije], François Marquié [ushtar në skuadrën e 17-të të trenit të ekuipazhit në Montauban, me leje pushimi 24-orëshe], Jean Cazaux [rojë në Shtëpinë Pilter, në Toulouse, i cili gjendej përkohësisht në Ayguesvives] në një hangar të vogël dhe i raportoi ata në xhandarmërinë e Montgiscard-it, e cila i arrestoi përfundimisht.

LEJTENANT AVIATORI MOISIU, AKTORI GJERMAN

Le Gaulois, e enjte, 16 mars 1916, faqe 3:

**Le lieutenant aviateur Moissi
comédien allemand**

Du correspondant particulier du *Petit Journal* à Zurich :

Le *Petit Journal* a annoncé la tentative d'évasion et la capture du lieutenant-aviateur Moissi qui, dans la vie civile, est l'artiste le plus populaire du *Deutsches Theater* de Berlin. Moissi n'est pas absolument inconnu à Paris : il a joué plusieurs fois au Vaudeville, dans les représentations organisées en 1913, par le *Deutsches Theater* et son directeur Max Reinhardt.

Ce qu'on sait moins en France, c'est que cet acteur berlinois est Italien de naissance, et que sa naturalisation en Allemagne est de très fraîche date. Alessandro Moissi est né à Prague de parents italiens ; il peut avoir 35 ou 36 ans. Il était, il y a une douzaine d'années, simple figurant au théâtre municipal de Prague, lorsqu'il fut découvert par Max Reinhardt, qui lui avait vu jouer d'une manière remarquable un petit rôle muet. Max Reinhardt emmena le jeune Moissi à Berlin, se chargea de son éducation dramatique, et le « lança » avec le plus grand succès lorsqu'il sut prononcer correctement l'allemand. En peu de mois, Moissi devint le principal sujet de la troupe, et le « jeune premier » fêté des Berlinoises.

Si je suis bien informé, Moissi ne s'est fait naturaliser Allemand qu'à la veille ou peut-être même au début de la guerre. Il est entré ensuite dans le corps des aviateurs comme engagé volontaire. Lorsqu'il fut fait prisonnier, les journaux de Berlin firent une campagne pour que le gouvernement allemand tentât de l'échanger. Mais il y a une double raison pour qu'on soit peu disposé, en France, à lui accorder un traitement de faveur. Le fait que Moissi est un artiste d'un talent incontestable ne peut faire oublier qu'il est un renégat italien. D'autre part, Moissi, dès le début de la guerre, a pris parti pour l'Allemagne avec l'ardeur d'un homme qui avait à se faire pardonner son origine, et il a copieusement injurié la France, dont il avait pourtant sollicité les applaudissements. Il n'est pas mauvais qu'il ait maintenant l'occasion et le loisir d'apprendre à nous mieux connaître.

Nga korrespondenti i veçantë i “Le Petit Journal” në Zyrih:

“Le Petit Journal” njoftoi për tentativën e arratisjes dhe për kapjen e lejtent-aviatorit Moisiu, i cili në jetën civile është artisti më i njohur në “Deutsches Theater” në Berlin.

Moisiu nuk është absolutisht i panjohur në Paris: ai ka luajtur disa herë në Vaudeville, në shfaqjet e organizuara në vitin 1913, nga “Deutsches Theater” dhe nga regjisori i saj Max Reinhardt.

Ajo që dimë më pak në Francë është se ky aktor berlinez është italian me origjinë dhe se natyralizimi i tij në Gjermani është mundësuar kohët e fundit. “Alessandro Moissi” ka lindur në Pragë nga prindër italianë, ai mund të jetë 35 ose 36 vjeç. Para dymbëdhjetë vjetëve, ai ishte një figurant i thjeshtë në teatrin komunal të Pragës, kur u zbulua nga Max Reinhardt-i, që e kishte parë të luante në mënyrë të përkryer një rol të vogël pa zë.

Max Reinhardt-i e mori Moisiun e ri në Berlin, u mor me edukimin e tij dramatik dhe e “lançoi” atë me suksesin më të madh, kur arriti të fliste saktë gjermanishten. Pas disa muajsh, Moisiu u bë subjekti kryesor i trupës, dhe “i riu i parë” i duartrokatur nga berlinezët.

Nëse jam i informuar mirë, Moisiu u natyralizua gjerman një ditë para ose në fillimin e luftës. Ai pastaj u angazhua në trupat e aviatorëve si vullnetar. Kur u burgos, gazetat e Berlinit bënë fushatë që qeveria gjermane të përpiquej ta shkëmbente atë. Por ka një arsye të dyfishtë pse ngurrojmë në Francë t’i lejojmë atij një trajtim të favorshëm.

Fakti që Moisiu është një artist me talent të pamohueshëm nuk mund të na bëjë të harrojmë se ai është një renegat italian. Nga ana tjetër, Moisiu, që nga fillimi i luftës, përkrahu Gjermaninë me zellin e njeriu që kërkonte ta falnin për origjinën e tij dhe ofendoi gjerësisht Francën, të cilës i kishte kërkuar duartrokitjet. Nuk është keq që tani ai ka mundësinë dhe kohën e lirë të na njohë më mirë.

“MORGEN POST” - ALEKSANDËR MOISIU,
AVIATOR NË ARRATI

Le Figaro, e martë, 6 qershor 1916, faqe 2:

La *Morgen Post* de Berlin, dans son numéro du 2 juin, rapporte que l'acteur allemand Alexandre Moissi, qui servait comme lieutenant aviateur et avait été fait prisonnier en France, vient de traverser Genève avec vingt-cinq prisonniers de guerre allemands malades, et hospitalisés en Suisse.

Moissi, il y a quelque temps, avait réussi à s'évader du camp français où il était interné, mais avait été arrêté, tout près de la frontière espagnole, après avoir parcouru en trois jours cent quarante kilomètres.

On voit que cette tentative d'évasion, loin de lui valoir le redoublement de rigueur et l'engeôlement impitoyable qui, en Allemagne, attendent ceux des nôtres qui essaient de fuir et sont repris, n'a pas détourné les autorités françaises de prendre à son égard une mesure de clémence.

On se demande au fond de quelle oubliette les Boches enverraient pourrir Garros, si Garros s'avisait, en vain, de s'évader.

“Morgen Post” e Berlinit, në numrin e saj të 2 qershorit, raporton se aktori gjerman Aleksandër Moisiu, i cili shërbeu si lejtentant aviator dhe ishte zënë rob lufte në Francë, sapo ka kapërcyer Gjenevën me njëzet e pesë gjermanë të burgosur lufte, të sëmurë dhe të shtruar në spital në Zvicër.

Moisiu, disa kohë më parë, kishte mundur të arratisej nga kampi francez, ku ishte i internuar, por e arrestuan shumë afër kufirit spanjoll, pasi kishte përshkuar brenda tri ditësh njëqind e dyzet kilometra.


Ne shohim që kjo përpjekje për t’u arratisur nuk e ka dyfishuar ashpërsinë dhe mizorinë e autoriteteve franceze, të cilat reagues me butësi ndaj tij, ndërsa e kundërta ndodh në Gjermani ndaj trupave tona, që kapen kur përpiqen të ikin.

Lind pyetja se në cilin vend të izoluar do ta dërgonin gjermanët Garros¹-in që të kalbej, nëse Garros-i do të guxonte, më kot, të shpëtonte.

¹ Roland Garros (1888-1918): aviator i njohur francez.

SI FISHKËLLEJNË NË GJERMANI

Comoedia, e premtë, 5 mars 1920, ballinë:




Comment on siffle en Allemagne.
 A Hambourg, conte le *Berliner Tageblatt*, salle du Konventgarten, l'artiste Alexandre Moissi avait organisé une récitation de Gœthe, Heine et Tolstoï.

La personnalité de cet interprète ne plaisait pas à un groupe de spectateurs pan-germanistes.

On n'utilisa pas les pommes cuites ou les trognons de choux de l'époque classique. Les denrées alimentaires ont trop de valeur. La science boche sut fournir des *ersatz*. La représentation fut troublée par une savante préparation de pétards, de fusées, et de grenades suffocantes. Enfin, on donna l'assaut à coups de chaises.

La manière forte est toujours, on le voit, le procédé de polémique de l'allemand.



Në Hamburg, tregon Berliner Tageblatt, në sallën Konventgarten, artisti Aleksandër Moisiu kishte organizuar një recitim të Goethe-s, Heine-s dhe Tolstoi-t.

Personaliteti i këtij interpretuesi nuk i pëlqente një grupi spektatorësh pangjermanë.

Nuk u përdorën patatet e ziera apo bishtat e lakrave të kohës klasike. Ushqimet kanë shumë vlerë.

Shkenca boche¹ arriti të siguronte disa “ersatz²”. Shfaqja u shqetësua nga fishekzjarret, kapsollat dhe granatat me aromë të rëndë.

Gjatë shfaqjes u krijua rrëmujë me anë të goditjeve të karrigeve.

Mënyra e dhunshme është gjithmonë, siç e shohim, mënyra e gjermanëve për të bërë polemikë.

¹ Term përbuzës i përdorur nga francezët ndaj gjermanëve.

² Elemente zëvendësuese.

MANIFESTIME ANTISEMITE

La Tribune Juive, e preme, 2 prill 1920, faqe 11:

Manifestations antisémites.

Nous avons récemment rapporté la protestation des étudiants de Karlsruhe contre la nomination du Professeur Mayer au poste de professeur de l'Ecole Polytechnique. Le Bureau de la Correspondance juive de Londres reçoit en outre, d'Hambourg, la nouvelle que le fameux acteur berlinois Alexandre Moïssi qui vint dans cette ville pour y lire des vers en fut empêché par des protesta-


Kohët e fundit kemi raportuar protestën e studentëve të Karlsruhes kundër emërimit të profesorit Mayer si profesor në Shkollën Politeknike.

Zyra e Korrespondencës hebraike në Londër mori gjithashtu lajmin nga Hamburgu se aktori i njohur berlinez Aleksandër Moisiu, i cili erdhi në këtë qytet për të lexuar disa vargje, u pengua nga manifestimet e shpeshta me karakter antisemit.

Në të gjitha rrugët e Këlnit janë ngjitur postera nga shoqatat pangjermane që kërkojnë që popullata të rebelohet kundër zgjedhës hebraike. Janë shpërndarë trakte të shumta me të njëjtën përmbajtje.

ALEKSANDËR MOISIU NË TURNE NË HOLANDË

Comoedia, e enjte, 6 nëntor 1924, faqe 2:



Aktori i madh Aleksandër Moisiu ishte në turne në Holandë. Turneu i organizuar nga z. Hugo Helm, mbushi sallat ndërsa luante “Die Jüdin von Toledo” të Grillparzer-it; “Der Arzt am Scheideweg” të Bernard Shaw-t, dhe “Hanneles Himmelfahrt” të Gerh. Hauptmann-it.